

# "Kryeministri Berisha po tërheq zvarrë komunitetin e ndërtuesve"

Ligji për Këshillin e Rregullimit të Territorit të kryeqytetit është konsideruar nga ana e drejtuesve më të lartë të pushtetit okal në Tiranë si antikushitetues dhe pasojë e dhunës së kartonëve në Parlament. Edhe ky ligj do të cetë fatin e një serie të gjatë të frafteve të miratuara së fundi nga kuvendi, që përfundojnë në duart e Gjykatës Kushtetuese, autoritetit më të lartë, që rëndos edhe për gabimet e kuvendit. "Me këtë ligj po ërhiqet zvarrë komuniteti i ndërtuesve". Ka qenë ky koment i bërë dje, nga përfaqësuesit e Bashkisë së Tiranës, idhur me disa ndryshime në ligjin e miratuar dy net më parë në Kuvend, atë për urbanistikën. Në këtë ligj përaktohet funksionimi dhe përbërja e anëtarëve të KRRT-së së kryeqytetit. Por, pretendimi qeveritar për atë ligj e kanë quajtur si zgjidhje" apo "transparncë" në marrjen e vendimeve në ligjin për KRRT-në e Tiranës, duket se nuk bën letër veçse krijon një nyje të zgjidhshme dhe pikë bllokimi, për vetë ndërtuesit he lejet e ndërtimit në ryeqytet. Kjo edhe për faktin se diferenca e pjesëmarrësve mes përfaqësuesve të ashkisë dhe atyre të qeverisë në këtë organizëm është etëm me një votë. Kjo e bën rejt të pamundur marrjen e endimeve nga ana e KRRT-së kryeqytetase edhe si pajje e konflikteve të ashpra he marrëdhënieve të tenonuara, që ekzistojnë midis ushtetit qendror dhe atij lokal në Tiranë.

Drejtori i kabinetit të ashkisë së Tiranës, Eduart ralsi, u shpreh dje, se "ligji i aprior për Këshillin e Rregullimit të rritorit të Tiranës është një abum i mirëfilltë me forcën e kar-

prej të cilëve janë kryetari i bashkisë, një funksionar i Ministrisë së Punëve Publike dhe një anëtar i fundit, që kërkohet me konsensus për të pasur një transparencë më të madhe të vendimmarrjes".

Që prej 8 muajsh, KRRT-ja e Tiranës është inekzistente, pasi nuk ka funksionuar. Një gjë e tillë ka krijuar një problematikë shumë

## KERKESA

Ky është një ligj antikushitetues. Presidenti i Republikës duhet ta kthejë në Kuvend", deklaroi Shalsi, duke shtuar se Bashkia e Tiranës do ta ridërgojë nga ana e saj në Gjykatën Kushtetuese këtë ligj

të mprehtë në sektorin e ndërtimit, pasi ajo është organi i vetëm, që ka të drejtën ekskluzive për të lëshuar lejet e ndërtimit në kryeqytet. Një gjë e tillë, jo vetëm që ka ndikuar negativisht në rritjen e çmimit të shitjes së apartamenteve, por ka "kontribuar" edhe në pezullimin e punës në këtë sektor. A. Rr.



## REAGIMI

Drejtuesit e Punëve Publike: Po zhbllokojmë situatën

## VENDIMI

Premtohen lehtësira në dhënien e licencave në këtë sektor

## Kundërshtimet

### Ndërtuesit: Të fillojë puna, jemi në kolaps

Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë vetëm pak kohë më parë i ka dërguar një letër të hapur Ministrisë së Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit. Në këtë letër-kërkesë, ndërtuesit shqiptarë kanë paraqitur të gjitha pakënaqësitë e tyre dhe vështirësitë që hasin çdo ditë në këtë sektor. Por më i ndjeshmi në listën e gjatë të problematikave ka qenë bllokimi i punës së Këshillit të Rregullimit të Territorit për kryeqytetin. Kjo edhe për faktin se bashkë me të është bllokuar edhe procesi i dhënies së lejeve të ndërtimit, gjë që sipas ndërtuesve e bën të pamundur vazhdimin e punës në këtë sektor. Aktualisht, puna vijon me lejet e marra që një vit më parë. Një gjë e tillë, përveçse vështirëson punën e ndërtuesve në kryeqytet, rëndon mbi qytetarët, të cilët përballen çdo ditë e më shumë me rritjen e çmimit të bane-save, jo për shkak të kostos së tyre, por prej ngërçit të detyruar të punimeve.



Kryeqyteti kremton ditën evropiane që bashkon njerëzit me njëri-tjetrin

## Tirana, në "festën e fqinjësisë"

Festa e fqinjësisë". Kjo është tradita më e re që ka filluar të krijohet edhe në kryeqytetin shqiptar, ceremoni kjo që zhvillohet suksesshëm në shumë vende të Bashkimit Evropian dhe më gjerë.

Dje, Bashkia e Tiranës organizoi për të dytin vit radhazi këtë festë në kuadër të "Ditës Evropiane të Fqinjësisë së Mirë". Përmes projektit "të zhvillojmë së bashku kuptimin e vërtetë të komunitetit", në kryeqytet u organizuan aktivitete të ndryshme në bllokun e televizionit pranë "Top Channel". Kjo ditë synon të promovojë fqinjësinë dhe bashkëjetesën në komunitet sipas standardeve evropiane, duke i ndërgjegjësuar banorët për një mjedis të qëndrueshëm e të shëndetshëm si pjesë e strategjisë lokale, si dhe duke i bashkuar ata rreth një feste të vogël.

Nuk ka munguar as festa me barbeque dhe pije ku të ftuar kanë qenë banorët e zonës së bllokut të televizionit dhe qytetarët të tjerë. Kjo zonë përbëhet nga një komunitet i përzier nivelesh shoqërore si biznese, ambasada, shkolla, institucione social-kulturore, vila dhe pallate. Banorët të këtij komuniteti, u mblodhën së bashku me qëllim jo vetëm argëtimin, por edhe ndarjen së bashku të problemeve të tyre. "Ne konsistojmë në kthimin e saj në një "zonë

Drejtori i kabinetit të ashkisë së Tiranës, Eduart Shalsi, u shpreh dje, se "ligji i apro-uar për Këshillin e Rregullimit të territorit të Tiranës është një abum i mirëfilltë me forcën e karneve në dem të Kushtetutës së republikës së Shqipërisë, të Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore, të ligjit organik të pushtetit ndor në Shqipëri, si dhe të vetëmës së komunitetit". Më tej, Shalsi ka theksuar se "kandidati i eshëm për Bashkinë e Tiranës, i cili nuk kishte asnjë lidhje me qytetin, me problemet dhe erëzit e saj dhe ministri i sotëm, po dëshmon çdo ditë e më tepër nuk ka asnjë lidhje me detyrën e tij të re, tregoi me këtë rast se e tija lidhje që kanë qeveritarët në është litari i Kryeministrit, që tërheq zvarrë komunitetin e lërtuesve, duke deformuar rditë tregun e banesave dhe ke cenuar e goditur drejtpërdrejt ekonominë e qytetit dhe këmbësorët bashkisë.

"Ky është një ligj antikush-tes. Presidenti i Republikës shet ta kthejë në Kuvend", deklaroi Shalsi, duke shtuar se Bashkia e Tiranës do ta ridërgojë nga ana e saj në Gjykatën Kushtetuese të ligj. Ai ka sqaruar më tej dhe atëgjatë që do të ndiqet nga erërit e pushtetit lokal në qytetet për të kundërshtuar rritjen në fuqi të këtij ligji. "Kryetari i bashkisë do të thërrasë një konsultë të gjerë paraprake të përshuesve të grupeve të interes-shoqërisë civile, si dhe të komitetit për të mbledhur mendimet e parashtruar një plan veprimi rra se t'i drejtohet zyrtarisht shillit bashkiak me një projekt nket kundër uzurpimit të shkisë së Tiranës nga qeveria uale", deklaroi Eduart Shalsi. ana tjetër, vetë ministri i nëve Publike, Transportit dhe ekomunikacionit, Sokol Oll-shi, në mbrojtje të ligjit në Par-ent u shpreh se "planifikohet përberje prej 6 anëtarësh, tre

## REAGIMI

# Drejtuesit e Punëve Publike: Po zhbllokojmë situatën

## Ministria: Kundërshtimi i bashkisë, shkak korrupsioni

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit i ka konsideruar kundërshtimet e ligjit të urbanistikës nga ana e Bashkisë së Tiranës si një "përpjekje për të ruajtur praktikën e korrupsionit masiv me lejet e ndërtimit dhe të kaosit urban në kryeqytet". Në qëndrimin zyrtar të këtij institucioni bëhet e ditur se "projekti i propozuar nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, në fakt vetëm ezhbllokoi situatën, duke i dhënë frymëmarrje industrisë së ndërtimit, nga e cila Bashkia e Tiranës vjel rreth 26 për qind të të ardhurave të veta". Sipas përfaqësuesve të Ministrisë së Punëve Publike,



Ndryshimet në ligjin për urbanistikën i japin fund situatës së bllokimit të lejeve të ndërtimit

"ndryshimet e miratuara në ligjin për urbanistikën i japin fund situatës së bllokimit të lejeve të ndërtimit në kryeqytet, sikurse zgjidhin një sërë problemesh procedurale që lidhen me ndërtimin e akteve rrugore kombëtare". Ata janë shprehur se ndryshimet janë tërësisht në përputhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese dhe me principet e Kartës Evropiane të

Autonomisë Vendore dhe për këtë kanë renditur disa argumente që, sipas tyre, pretendohet se përligjin një qëndrim të tillë. "Raportet e përfaqësimit në KRRT-në e Tiranës, pas ndryshimeve të bëra në ligjin për urbanistikën janë 8 nga pushteti vendor dhe një nga pushteti qendror, nga 8 me 13 që ka qenë ky raport më parë, në favor të pushtetit qendror", thuhet në qëndrimin zyrtar të kësaj ministrie. Aty shtohet se "vendimmarrja e KRRT-së parashikohet meshumicë të thjeshtë në të gjitha rastet, me përjashtim të planit të përgjithshëm rregullues dhe planeve rregulluese zonale, miratimi i të cilëve kërkon votat e 6 prej nëntë anëtarëve". Ndërkohë që, kjo është një ndër pikat më të kundërshtuara, pasi për të arritur kuorumin e duhur për vendimmarrje kërkohej konsensus. Por, kjo fjalë duket krejt e pamundur, nisur nga marrëdhëniet konfliktuale dhe tejet të vështira mes krerëve të këtyre dy institucioneve, përkatësisht kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Edi Rama, dhe ministrit të Punëve Publike, Sokol Olldashi.

## VENDIMI

# Premtohen lehtësira në dhënie e licencave në këtë sektor

## Ministria e Bujqësisë ul 300 tarifa shërbimesh

Ministria e Bujqësisë ka rishikuar të gjitha tarifën e shërbimeve që ka me institucionet në vartësinë e saj dhe që i aplikon ndaj fermerëve dhe agrobiznesit në vend. Aktualisht, aplikohen rreth 300 lloje tarifash për analiza laboratorike të të gjitha llojeve, marrje mostrash për mallra që importohen dhe tregtohen në vend, për pajisje me leje tekniko-teknologjike, leje importi, certifikim fara-fidanësh, import dhe regjistrim pesticidesh. Rishikimi i këtyre tarifave është bërë në tri nivele. Janë eliminuar tërësisht tarifën për plehrat kimike, që kanë qenë deri në 14.000 lekë të reja për analizat, si dhe ato për disa inspektime fushore në prodhimin e farave dhe sektorin fitosanitar. Janë reduktuar në masën 50-70% tarifën për certifikimin e farave dhe fidanëve të importit, si dhe ato të prodhuar në vend.

Janë ulur tarifën për analizat e zakonshme të produkteve ushqimore dhe për ato që kryhen në laboratorët e veterinarisë, si analizat bak-

teriale, virale apo kimike që kanë pasur një kosto prej 12-13 mijë lekësh. Tarifa për to bëhet 6-7 mijë lekë. Janë reduktuar 3-4 herë edhe tarifën për regjistrimin e pesticideve me lëndë vepruese të re nga 300 mijë në 100 mijë lekë. Ndërsa pagesat për regjistrimin e



Janë ulur tarifën për analizat e zakonshme të produkteve ushqimore në laboratorët e ushqimit

pesticideve me lëndë vepruese të vjetër nga 200 mijë lekë bëhen 50 mijë lekë. Sipas zëvendësministrit të Bujqësisë, Ndoc Faslia,

të gjitha tarifën e mbetura dhe që do të paguhet nga biznesi apo fermerët janë në nivelin e kostos reale të shpenzimit që kryhet për analizën laboratorike apo shërbimin përkatës. "Pas amendimeve të domosdoshme që do të bëhen në legjislacionin përkatës në sektorin e sigurisë ushqimore, veterinarisë, shërbimit fitosanitar një rishikim tërësor do të bëhet edhe për lejet dhe licencat që i jepen sot biznesit, një pjesë e të cilave do të hiqen plotësisht dhe një pjesë tjetër do të ketë thjeshtim të ndjeshëm të dokumentacionit që kërkohej aktualisht", ka premtuar zëvendësministri i Bujqësisë, Faslia. A. Rr.

vila dhe pallate. Banorë të këtij komuniteti, u mblohdën së bashku me qëllim jo vetëm argëtimin, por edhe ndarjen së bashku të problemeve të tyre. "Ne konsistojmë në kthimin e saj në një "zonë model" në aspektin mjedisor dhe social", u shprehën përfaqësuesit e bashkisë. Sipas tyre, është zgjedhur pikërisht kjo zonë e komunitetit për vetë faktin se prej më se një viti këtu po zbatohet një projekt për selektimin dhe riciklimin e mbetjeve urbane, si dhe është një zonë e rikonstruktuar rishtazi. Synimi i Bashkisë së Tiranës në organizimin e këtij aktiviteti ka qenë edhe fakti që nëpërmjet këtyre ditëve të rëndësishme ajo mundohet të tërheqë vëmendjen e mbarë komunitetit për të marrë masa mbrojtëse dhe rigjeneruese për mjedisin, si një balancë natyrore që krijohet për mirëqenien e njerëzimit. Gjithashtu, tentohet edhe tërheqja e vëmendjes së institucioneve shtetërore, forcimi i lidhjeve publik-privat-shoqëri civile, mbi problemet mjedisore dhe mbrojtjen e tij nëpërmjet iniciativave të përbashkëta. Aty u bë edhe vendosja e tabelave të tipit vlerësues dhe udhëzues nëpër pikat e grumbullimit të mbetjeve urbane, të cilat do të orientojnë komunitetin për një trajtim sa më të mirë të mjedisit. Ideja e Ditës së Fqinjësisë së Mirë lindi në vitin 1990, kur Atanase Périfan dhe miqtë e tij krijuan shoqatën "Parisi i miqve - sfida për miqësi" për të nxitur lidhjet në vazhdimësi ndërmjet njerëzve dhe për t'i mobilizuar ata të veprojnë kundër izolimit. Kjo ditë do të shërbejë dhe për krijimin e një ndjenje dhe kulture bashkëjetese, respekti dhe miqësi të komunitetit me njëri-tjetrin. A. Rr.

Drejtoresha e gjimnazit "Petro Nini", shpjegon arsyen e vendosjes së pagesës për nxënësit e këtij gjimnazi. Drejtoresha e shkollës, Diana Kolemi ka shpjeguar se pasi është bërë një inventar i materialeve të shkollës, ka rezultuar se ka pasur shumë dëme materiale. "Në shtator është bërë dorëzimi i shkollës dhe i bazës materiale me inventarë, procedura këto që bëhen çdo vit dhe është vënë firma ime", - ka sqaruar drejtoresha. Sipas saj, çdo klasë në shtator ka pasur 12 tavolina dhe 45 karrige, ndërsa aktualisht, numri i karrigeve është reduktuar shumë nëpër klasa. Vendimi për pagesën e dëmeve të shkaktuara nga pakujdesia e nxënësve, nuk është vendosur vetëm nga drejtoresha dhe tri nëndrejtoreshat që ka kjo shkollë, por është vendosur nga i gjithë stafi pedagogjik i shkollës gjatë një mbledhjeje në datën 7 maj. Drejtoresha Konomi ka deklaruar se "për të bërë verifikimin dhe blerjen e mjeteve me lekët që do të mblidhen nga nxënësit, është vendosur që të ngrihet dhe një komision me tre nxënës, mësuesin kujdestar të klasës dhe një prind". Ndër të tjera, pjesa më e madhe e nxënësve në të gjitha gjimnazet e kryeqytetit ka paguar që në fillim të vitit nga 10 mijë lekë



## Alarmi, pasi nxënësve iu ndalua ekskursioni

Bërja publike e kësaj "gjobe" nga nxënës të shkollës dhe sidomos prej maturantëve në gjimnazin "Petro Nini", mendohet të jetë një mënyrë "ndëshkimi" nga ana e tyre, pasi nuk kanë mundur të shkojnë në një ekskursion në Sarandë. Çdo gjë në lidhje me ekskursionin që duhet të bënin vitet e katërta të këtij gjimnazi, kanë qenë gati. Por mesa duket, hovi i këtyre të rinjve është prere në mes, pasi mësuesit nuk e kanë marrë përsipër t'i shoqërojnë në një rrugë të gjatë, duke mbajtur çdo përgjegjësi mbi supet e tyre. Ndërkohë, me një vendim më datë 23 maj, Ministria e Arsimit ka vendosur se çdo ekskursion duhet të bëhet me leje nga Drejtoria Arsimore. Në mënyrë që të frenohen disi ekskursionet që bëhen nga nxënësit e shkollave, sidomos gjatë sezonit të verës. Ky vendim është marrë në lidhje me shqetësimin e mësuesve dhe vetë prindërve të nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar. Ndërkohë, maturantët e pyetur kanë pranuar se në klasat e tyre ka pasur disa probleme me dëmtimin e karrigeve dhe se janë duke përfunduar në mbledhjen e lekëve, ndërsa në lidhje me "ndëshkimin", kanë anashkaluar përgjigjen.

për bankat dhe karriget e shkollës. Aktualisht, vetëm gjimnazi "Petro Nini" bën përjashtim, pasi lekët nuk janë mbledhur ende.

### MËSUESIT

Stafi pedagogjik i gjimnazit "Petro Nini", ka pranuar se kanë qenë të gjithë dakord me vendosjen e një pag-

ese apo një mënyrë tjetër pagese për dëmet materiale të shkollës, që janë bërë gjatë këtij viti akademik. Sipas tyre, është bërë një verifikim i dëmeve materiale të shkollës dhe është vendosur nga i gjithë stafi që nxënësit të kontribuojnë për zëvendësimin e karrigeve të dëmtu-

### GJIMNAZET

Çdo gjimnaz në kryeqytet ka mbledhur lekë për të bërë zëvendësimin e dëmtimeve që janë bërë gjatë vitit mësimor në bazën materiale të shkollës

ara. Ndër të tjera është shpjeguar dhe arsyeja se pse është bërë inventari i materialeve të shkollës gjatë majit, gjë e cila bëhet në fund të vitit shkollor. Ka qenë pikërisht hedhja e një karrigeje nga dritarja e një klase të vitit të katërt, që ka detyruar stafin pedagogjik të këtij gjimnazi të nisë inspektimin për të verifikuar bazën materiale. Kjo gjë është verifikuar më së miri pas një vizite në ambientet e këtij gjimnazi, ku pas shkollës ka qenë një vend i mbushur vetëm me karrige të thyera nga pakujdesia e nxënësve. Mësuesit e kësaj shkolle kanë pranuar se drejtoresha u ka kërkuar që me administrimin e lekëve që do të mblidhen, të merren vetë nxënësit së bashku me mësuesit kujdestarë të çdo klase. Gjatë mbledhjes në datën 7 maj, është vendosur gjithashtu që me verifikimin e lekëve që do të mblidhen nga nxënësit e



Gjimnazi "Petro Nini"

kësaj shkolle, të merret një komision i posaçëm. Ky komision do të përbëhet nga tre nxënës, mësuesi kujdestar i klasës përkatëse dhe një prind. Pra, mbledhja e lekëve dhe shpenzimi i tyre do të bëhet në mënyrë transparente. Ky vendim ndër të tjera është e zezë në të bardhë, pasi është i dokumentuar dhe me firmën e të gjithë mësuesve të shkollës. Pjesë përbërëse e stafit pedagogjik të kësaj shkolle janë 70 mësues, të cilët merren me arsimimin e një brezi të tërë të rinjsh prej 1800 nxënësish. Drejtoresha Diana Kolami ka deklaruar se "me bazën materiale të shkollave merret ndërmarrja nr.3 e Bashkisë së Tiranës, me të cilët kemi kontaktuar për të na ndihmuar me karrige, por kemi marrë përgjigje negative, pasi ka mungesë fondi". Me tej, ajo ka sqaruar se ata u kanë sugjeruar të marrin karrige nga gjimnazi "Myslym Keta", pasi është në fazë rikonstruksioni dhe baza shkollore do të vendoset re. Por kjo metodë është praktikuar dhe nga gjimnaze të tjera si "Partizani" dhe "Ismail Qemali", ndaj "Petro Nini" nuk ka mundur të 'përfitojë', pasi karriget kishin përfunduar.

## Bashkia, aktivitet për Ditën e Fqinjësisë

Që prej një viti, edhe kryeqytet ka startuar tashmë tradita e kremtimit të Festës së Fqinjëve, në kuadër të Ditës Europiane të Fqinjësisë së Mirë. Bashkia e Tiranës ka organizuar aktivitete të ndryshme nëpërmjet projektit me titull: "Të zhvillojmë së bashku kuptimin e vërtetë të komunitetit". Aktiviteti është zgjedhur të bëhet në zonën pranë Televizionit Shqiptar, për vetë faktin se prej më se një viti, këtu po zbatohet një projekt për selektimin dhe riciklimin e mbetjeve urbane, si dhe është një zonë e rikonstruktuar rishtazi. Në këtë aktivitet janë mbledhur banorë të zonës, të cilët kanë treguar për problemet dhe shqetësimet që kanë, duke i ndarë me personat e tjerë të pranishëm. Në këtë aktivitet ka qenë pjesëmarrës dhe kryetari i Bashkisë së Tiranës, Edi Rama.